



Prof. Asoc. Rezart Dibra

Lektor

**Fakulteti i Biznesit dhe Drejtësisë
Tirana Business University College**

Prof. Asoc. Rezart Dibra është lektor në fushën e menaxhimit. Ai është diplomuar në Fakultetin e Ekonomisë dhe në Fakultetin e Drejtësisë. Ka përfunduar gjithashtu studimet Master i Nivelit të Dytë në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin e Nebraskës. Ka dhënë provime dhe ka kryer kurse të ndryshme kualifikimi pasuniversitar, duke përfshirë fusha të menaxhimit, financave, kontabilitetit, bankave dhe drejtësisë. Veçojmë kursin njëvjeçar të specialistëve të lartë të Financë-Bankës në Fakultetin e Ekonomisë, kualifikim ky në nivel master dhe më pas doktoraturën në fushën e menaxhimit.

Prof. Asoc. Rezart Dibra ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesioneve të lira si “Ndërmjetës i Pasurive të Paluajtshme”, “Kontabël i Miratuar” dhe “Avokat”. Ai ka punuar në institucione të ndryshme shtetërore dhe private, si dhe në institucione të arsimit të lartë private, ku ka shërbyer si pedagog dhe përgjegjës departamenti. Është pjesëmarrës në trajnime, seminare dhe konferenca të organizuara brenda dhe jashtë vendit. Si trajner, ai ka dhënë module të veçanta në kurse të ndryshme në fushën e financës, menaxhimit dhe drejtësisë.

Prof. Asoc. Rezart Dibra ka realizuar botime në revista të ndryshme shkencore brenda dhe jashtë vendit, si dhe ka botuar materiale për përdorim nga studentët. Ai ka marrë pjesë si autor/bashkëautor në referime shkencore në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe ka qenë pjesë e komiteteve shkencore organizative dhe bordeve editoriale të disa prej tyre. Gjithashtu, është editor anëtar/reviewer në konferenca dhe revista ndërkombëtare.